



[Type the text]



Republika e Kosovës

Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Komuna Rahovec - Opštine Orahovac

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë - Sektori për pronë

Odeljenje za Katastar, Geodeziju i Imovinu - Sektor za imovinu



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. i prot. 111 Më 16.07.2019
Br. prot. Dt. 16.07.2019
RAHOVEC - ORAHOVAC

RAPORT I PUNËS

JANAR- QERSHOR 2019

DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË

Qysh në fillim të vitit 2019 i jemi qasur punës në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara nga Kryetari i Komunës në përputhje me Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale, Statutin e Komunës së Rahovecit dhe Planin e Punës për Vitin 2019.

Gjatë periudhës gjashtë mujore për të cilën po raportojmë, të tre sektorët e Drejtorisë i kanë përfunduar këto punë:

Sektori:	Lëndët	Shuma €
Kadastër dhe Pronë	440	10,170 €
Gjeodezi	1127	9,810 €
Referenti	2,790+18 L.Z.	11,150 €
Totali	4,357+18 L.Z.	31,130 €

- Në bazë të planit për vitin 2019 kemi incizuar dhe përfunduar disa procese të shpronësimit për interes të përgjithshëm për hapje të rrugëve të reja, siç janë: shpronësimi dhe zgjerimi i rrugës "Edit Durham", akt vlerësimi i hapjes së rrugës publike nëpër parcelat e zonës kadastrale në Rahovec të fabrika e Plastikës etj.
- Kemi filluar në bashkëpunim me Agjensionin Kadastral të Kosovës dhe jemi ende në proces të inventarizimit dhe skenimit të dokumentacionit, i cili ende nuk është skenuar.
- Zyrtarisht kemi incizuar komplet rrugën që na dërgon te Maja e Shkodranit, rrugën Rahovec-Xërxë, Rahovec-Malishevë, rrugën tranzite deri te hyrja për tranzit për Therandë etj.
- Me kërkesë të avokatit të komunës, kemi përgatitur historiatet e parcelave kadastrale në nivel komune dhe kemi prezentuar dokumentacionin e kërkuar.
- Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për KPF për shpallje me interes të përgjithshëm të lëndëve në nivel Komune.
- Në bashkëpunim të ngushtë me Agjensionin Kadastral të Kosovës kemi përgatitur linjën zyrtare për ofrimin e shërbimeve edhe në pika të tjera të komunës, si në Krushë të Madhe dhe në Ratkoc, ky proces ka filluar shumë mirë dhe është duke treguar rezultatet e veta në ofrimin e shërbimeve qytetarëve edhe në këto zona.
- Me kërkesë nga DKRS janë evidentuar të gjitha parcelat publike në ZK si në Rahovec, Dejnë, Apterushë etj, për projektimin e fushave sportive.
- Me kërkesë të kryetarve të fshatrave kemi kufizuar rrugë publike, sheshe, varrezat e fshatit,

hapësirat e shkollës, rrugë fushore etj.

- Me kërkesë zyrtare të Inspektoratit kemi identifikuar parcelat të uzurpuara dhe kemi nxjerr aktvendime për uzurpim.
- Kemi përfunduar materialin e kërkuar nga Banka Botërore në lidhje me projektin për modernizimin e sistemit të ujitjes në të gjitha zonat kadastrale.
- Përgjigje në kërkesat e parashtruara nga Avokati i Komunës.

Me respekt!


Afrim Oruqi
Drejtor i DGJKP-së